



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA III

Sesioni Vjeshtor

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport

Mbledhja nr. 55.

Prishtinë, më 28.09.2010 ora 11:00.

Ndërtesa e Kuvendit, sala N – 302.

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ARSIM, SHKENCË, TEKNOLOGJI,
KULTURË, RINI DHE SPORT

Në mbledhje morën pjesë : Arsim Rexhepi, kryetar, Drita Kadriu, Enis Kervan, Donika Kadaj – Bujupi, Heset Cakolli, Mark Krasniqi dhe Dragan Dimiq.

Mungoi : Ismajl Kurteshi.

Emrat e të ftuarve dhe të pjesëmarrësve të tjerë:

- Enver Hoxhaj – Ministër i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë,
- Avdulla Alija – Drejtor i Departamentit të Arsimit të Lartë – MASHT,
- Osman Shahini – Udhëheqës i Zyrës për Arsim dhe Aftësim Privat – MASHT.

I pranishëm në mbledhje të komisionit ishte Bujar Dugolli deputet i pavarur.

Nga stafi mbështetës i komisionit : Lule Ymeri dhe Shaip Goxhuli.

Mbledhjen e kryesoi Arsim Rexhepi, kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 21.09.2010,
3. Informatë nga Ministri i Arsimit, Shkencës, Teknologjisë lidhur me çështjet :
 - nostrifikimi i diplomave,
 - funksionimi i kolegjeve të palicencuara dhe
 - vulave të diplomave;
4. Të ndryshme.

Kryesuesi - konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryesuesi - kërkoi nga anëtarët e komisionit të deklarohen lidhur me pikat e rendit të ditës.

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 21.09.2010.

Kryesuesi - konstatoi se Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport miratoi procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 21.09.2010 pa vërejtje.

3. Informatë nga Ministri i Arsimit, Shkencës, Teknologjisë lidhur me çështjet :

- **nostrifikimi i diplomave,**
- **funksionimi i kolegjeve të palicencuara dhe**
- **vulave të diplomave.**

Kryesuesi - lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kryesuesi ia dha fjalën ministrit që të informojë anëtarët e komisionit për çështjet e ngritura.

Enver Hoxhaj - theksoi se çështjet që janë ngritura nga ana e komisionit kanë qenë një shqetësim edhe për ministrinë dhe vazhdojnë të mbesin si të tilla, por thekson se janë bërë lëvizje shumë pozitive, ndër të tjera shtoi se termi „ Nostrifikim ” tanimë është i kaluar dhe se tani përdoret termi „ Njohje ”. Ai i njoftoi anëtarët e komisionit se në bashkëpunim me Austrinë në vitin 2008 është themeluar qendra NARIC Kosova- Qendra Kombëtare për njohje të diplomave, qëllimi dhe misioni i saj është që të merret me njohjen, barasvlerën, me transferin e certifikatave, diplomave dhe të gjitha ato që dalin nga sistemi jonë arsimor. Deri në fund të vitit 2008 ka pasur pritje të gjata për njohje të diplomave dhe që nga viti 2008 është themeluar grupi i ekspertëve i cili grup i ekspertëve përbëhet nga pjesa më e madhe e profesorëve të UP-së të cilët në mënyrë shumë dinamike janë marrë me çështjet e njohjes dhe të barasvlerës së diplomave. Është një keqkuptim në bazë të asaj që njerëzit kërkojnë dhe ai me këtë rast ka përmendur disa raste të cilat ata përballen në përditshmërinë e tyre, ku disa kualifikime semestrale të kryera në vendet e rajonit kërkojnë që në Kosovë të njihen si grada shkencore.

Sa i përket çështjes së funksionimit të kolegjeve të palicencuara, si ministri kemi informacionin se kemi të bëjmë me tri institucione së pari për Universitetin Internacional të Strugës i cili ka pas reklamë por nuk funksionon, Universiteti Kristal nga Shqipëria i cili nuk funksionon. Ministri përmendi se ekziston një shkollë e gazetarisë KIAC e cila është e themeluar nga një universitet nga SHBA dhe Britania e Madhe(Kardif), ky institucion nuk ka akreditim dhe gjatë këtij viti ata do të nënshtrohen procesit të akreditimit, po ashtu ekziston edhe një institucion i Kombeve të Bashkuara i cili funksionon në Prizren në bazë të një marrëveshje të vitit 2007, ata pretendojnë se kanë akreditim nga Kombet e Bashkuara dhe kemi kërku ndihmë përmes Ministrisë së Punëve të Jashtme të Kosovës që të dalim prej kësaj situatë.

Sa i përket çështjes së vulave ministri tha se ky është një proces i rregullt i cili duhet të vërtetohet nga departamenti i inspektimit i cili e verifikon rastin dhe e lëshon vulën. Na duhet kohë për një gjë të tillë dhe se e gjithë kjo procedurë nuk mund të kryhet brenda ditës.

Drita Kadriu - theksoi se çështja e ligjeve nga kjo ministri është me prioritet për komisionin, mirëpo njëra ndër çështjet që është ngrit në mbledhjen e fundit është ajo e njohjes së diplomave, ku u paraqiten edhe disa raste konkrete.

Donika Kadaj – Bujupi - diskutoj lidhur me çështjen e vonësës së njohjeve të diplomave dhe kërkoj njohuri lidhur me afatin kohorë të përcaktuar për verifikimin e njohjes së diplomave. Përmendi një shembull të një kardiologu të QKUK i cili ka pritur katër vite për njohje të diplomës.

Heset Cakolli - tha se MASHT-ti duhet të ketë kujdes në këtë proces i cili merr kohë dhe kërkon verifikim të detajuar. Ai kërkoj sqarim nga ministri lidhur me njohjen e diplomave të studentëve tanë të cilët përfundojnë studimet në institucionet private të arsimit të lartë në rajon.

Adem Hajdaraj – pyeti përfaqësuesit e ministrisë, a ka pasur raste të ndonjë diplome false dhe shtroj pyetjen lidhur me atë se a është ndërmarrë diçka nga ministria lidhur me shtyrjen e afatit të pensionimit të stafit akademik.

Mark Krasniqi – tha se njohja e diplomave është një proces që donë verifikim dhe vlerësim të detajuar andaj kërkohet kohë për një vlerësim të tillë.

Enis Kervan – foli lidhur me njohjen e diplomave të shkollave të mesme të nxënësve nga Turqia si dhe kërkoi informatë lidhur me studentët të cilët përmes OJQ-ve dhe shoqatave të ndryshme vijojnë studimet në Turqi.

Bujar Dugolli – deputet i pavarur ngriti çështjen e cilësisë në institucionin publik të arsimit të lartë si dhe shtroj çështjen e institucioneve private të arsimit fillor e të mesëm të cilat licencohen për një periudhë kohore një vjeçare.

Kryesuesi – tha se lidhur me çështjen që po debatohet janë ngritur shqetësime nga disa individë siç është rasti i një studenti nga Austria dhe një tjetri nga kolegji Dardani, për të cilët është dashtë që të pritët një kohë të gjatë për verifikim të diplomave.

Avdulla Alija – Drejtor i Departamentit të Arsimit të Lartë – MASHT – e njoftoj komisionin se procesi i njohjes së diplomave kryhet nga një grup i ekspertëve që është emru nga Universiteti i Prishtinës. Çdo vendim i marrë për njohje përmban informatën e saktë se cilës njohje i përket. Ai tha se vonesat për njohje në të kaluarën kanë ngjarë ndërsa kjo është bërë për faktin se vendet fqinjë kanë vonuar informatat kthyesë. Sa i përket çështjeve të ngritura nga komisioni lidhur me disa vonesa ai dha shpjegimet e duhura.

Osman Shahini – Udhëheqës i Zyrës për Arsim dhe Aftësim Privat – MASHT – theksoi se procesi i akreditimit ka ndikuar në vonesën e njohjeve të diplomave të institucioneve private të arsimit.

Enver Hoxhaj – ju përgjigj anëtarëve të komisionit se ministria nuk i njeh diplomat e institucioneve private të arsimit të lartë të marrura në vendet fqinjë për arsye të procesit të akreditimit.

4. Të ndryshme

Kryesuesi – i njoftoi anëtarët e komisionit se shkresa e rektorit për të cilën është diskutuar në mbledhjen e kaluar ende nuk ka arritur në komision.

Mbledhja përfundoi në orën 12:45.

Përgatitur nga :

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

**Kryetari i Komisionit
Arsim Rexhepi**
